



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 597 prot

Tiranë, më 3.09 2026

VENDIM

Nr. 9 datë 3.09 2026

PËR
MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE
VENDORE TË DATËS 2/9/2026

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, si dhe në VKM nr. 244, datë 17.04.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme të mbledhjes së datës 02.09.2026 vendosi:

1. Për projektligjin “Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve” propozuar nga Ministria e Mjedisit bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektligjin.
2. Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” i ndryshuar, propozuar nga Ministria e Mjedisit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- Neni 10/2 “E drejta e ankimit administrativ dhe gjyqësor”. Ligji 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” i ndryshuar me Ligjin 68/2024 “Për një ndryshim në ligjin 162/2014...” dhe në vijim me Ligjin 99/2024 “Për inspektimin në RSH” neni 114/pika 4 parashikon mjetet procedurale ndaj masave administrative dhe sanksioneve në zbatim të këtij ligji, e më konkretisht ushtrimin e ankimit administrativ dhe atij gjyqësor sipas ligjit për inspektimin dhe KPRCA. Ndaj, nëse qëllimi i kësaj dispozite nuk ka të bëjë me rivendosjen e të drejtave të cënuara nga masat administrative në zbatim të këtij ligji, por ka të bëjë me të drejtën e subjekteve/individëve që nëpërmjet ankimit administrativ/gjyqësor të rivendosin të drejtat e cënuara nga planet e miratuara të cilësisë/planet e aglomeratit dhe planet kombëtare të cilësisë së ajrit në mjedis, sipas objektit të ligjit, duhet të specifikohet ky fakt.
3. **Për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 162 datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programit të pakësimit të shkarkimeve në ajër”,** propozuar nga Ministria e Mjedisit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin.
 4. **Për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” të ndryshuar,** propozuar nga Ministria e Brendshme bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektligjin.
 5. **Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.15/2019 “Për nxitjen e punësimit” i ndryshuar,** propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektligjin.
 6. **Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar,** propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
 - Në Nenin 11, pika “e”, të unifikohet me titullin e nenit 11/1 dhe të bëhet nga “Programi i banesave në treg të lirë për shitje” në “Programi i zhvillimit të banesave me destinacion të kombinuar”.
 - Neni 15/2 të shtohet me këtë përmbajtje: “Kategoritë e veçanta dhe format e mbështetjes përcaktohen sipas parimeve, kriterëve dhe prioriteteve të përcaktuara në këtë ligj, ndërsa kriteret e hollësishme, procedurat dhe masat e mbështetjes përcaktohen me vendim të


Këshillit të Ministrave. Shmanget delegimi i pakufizuar në VKM. Kategoritë dhe mbështetja duhet të kenë bazë në parimet dhe kriteret e ligjit dhe në përputhje me kategoritë e parashikuara nga kuadri ekzistues i strehimit social.

- Në nenin 18 të shtohet fjalia: “Tjetërsimi i pasurisë ose ndryshimi i destinacionit të saj, nuk mund të sjellë pakësimin e fondit publik të banesave sociale, përveç rasteve kur pasuria zëvendësohet me një pasuri tjetër me vlerë dhe destinacion të barasvlershëm ose më të favorshëm për fondin publik të banesave sociale.” Sigurohet ruajtja e fondit publik të banesave sociale, duke lejuar tjetërsimin ose ndryshimin e destinacionit vetëm kur pasuria zëvendësohet me një pasuri të barasvlershme ose më të favorshme.
 - Në nenin 19 bëhen këto ndryshime: Në pikën 1, togfjalëshi “në favor të fondit publik të banesave sociale” zëvendësohet me togfjalëshin “në favor të fondit publik të banesave sociale, i cili përdoret për të gjitha programet e strehimit social, të përdoret nga njësitë e vetëqeverisjes vendore edhe për projektimin dhe ndërtimin, e banesave të cilat do të kalojnë në pronësi të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen për shkak se preken nga realizimi i investimeve publike.
 - Në nenin 22, të shtohet fjalia: Ndryshimi i destinacionit nuk mund të sjellë uljen e numrit të banesave sociale me qira të përfshira në fondin publik, përveç rasteve kur, para ndryshimit të destinacionit, sigurohet një numër i barasvlershëm ose më i madh banesash sociale me qira. “Këshilli bashkiak duhet të justifikojë vendimin mbi bazën e nevojave të identifikuar. Në të njëjtën kohë, mbrohet konkretisht numri i banesave sociale me qira.
 - Në nenin 33, ku shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:
“Për mbështetjen e kategorive të veçanta me subvencionimin e qirasë krijohet një program i posaçëm, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, ku përcaktohen kategoritë përfituese, kriteret, masa e subvencionimit, procedurat e zbatimit dhe rregullat e administrimit të programit. ”VKM-ja nuk duhet të ketë kompetencë për të krijuar pa kufi kategori të reja. Ligji vendos bazën dhe parimet; VKM-ja përcakton zbatimin.
- 7. Për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Sektorit Minerar 2026-2040” dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) i Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Sektorit Minerar 2026-2040,** propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Të shihet një rol i shtuar i bashkive lidhur me masat që kanë të bëjnë me rehabilitimin mjedisor të zonave të dëmtuara nga aktiviteti minerar pasi komunitetet lokale janë ato të cilat përballen me pasojat e dëmtimeve në mjedis. Bashkitë janë të përfshira vetëm në 2 masa të saj: a) përditësimi i planeve kombëtare me zonat e zhvillimit territorial me

prioritet minerar; b) Identifikimi i zonave me konflikte hapësinore. Ky sugjerim vlen dhe për Hartimin e Planit Kombëtar të Rehabilitimit dhe Fondin e Rehabilitimit që do të krijohen sipas kësaj strategjie.

8. Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, propozuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim me projektligjin.

Z. Ervin Demo
Ministër Shteti për Pushtetin Vendor



Z. Aldrin Dalipi
Kryetar/Bashkëkryetar
Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë

